

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË VENDIM

KËRKESA NR. 37935/18 **TAHIR ÇUNI KUNDËR SHQIPËRISË DHE 2 KËRKESA TË TJERA** (Shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 maj 2024 si një Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *Kryetar,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e Seksionit e Përkohshme,*

Duke mbajtur në konsideratë kërkesat e mësipërme të depozituara në data të ndryshme të paraqitura në tabelën bashkëlidhur,

Duke mbajtur në konsideratë deklaratat formale me anë të të cilave pranohej një zgjidhje miqësore e çështjeve

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve paraqitet në shtojcë.

Ankesat e kërkesve në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse iu komunikuan Qeverisë shqiptare ("Qeveria"). Në disa prej kërkesave, ankesat e mbështetura në të njëjtat fakte u komunikuan sipas parashikimeve të tjera të Konventës.

Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore të nënshkruara nga palët, sipas së cilave kërkesit binin dakord që të hiqnin dorë nga kërkesa të tjera ndaj Shqipërisë për faktet që ngrinin këto kërkesa, pas marrjes përsipër nga Qeveria që t'i paguante atyre shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur. Këto shuma do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes së shumave dhe do të paguhen brenda tre muajve nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Në rast se këto shuma nuk do të paguhen brenda periudhës tremujore të përmendur më sipër, Qeveria merr përsipër të paguajë interes të thjeshtë ndaj shumave nga përfundimi i asaj periudhe deri në shlyerje në një normë të barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagesës plus tre pikë përqindje. Gjithashtu, Qeveria merr përsipër të sigurojë zbatimin e vendimeve vendëse në çështjet konkrete (shih tabelën bashkëlidhur) brenda të njëjtës periudhë tremujore, si edhe të paguajë çdo kosto për procedurat vendëse të zbatimit të vendimeve.

Pagesa dhe zbatimi i vendimeve vendëse në çështjet konkrete do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon me vend t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo është siguruar se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit në Konventë dhe protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave.

Mbështetur në sa më sipër, është me vend që çështjet të përjashtohen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos të bashkojë kërkesat;

Vendos të përjashtojë kërkesat nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.
Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 6 qershor 2024.

Viktoriya Maradudina **Peeter Roosma**
Zëvendëssekretare e përkohshme **Kryetar**

SHTOJCË

*Lista e kërkesave me anë të të cilave paraqiten ankesa sipas nenit 6 § 1 të Konventës
(moszbatimi ose zbatimi i vonuar i vendimeve vendëse)*

Nr.	Numri i kërkesës Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së kërkuarit	Shuma e akorduar për dëmin jo pasuror për kërkuar (në euro) ¹	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ²
1	37935/18 3.8.2018	Tahir ÇUNI 1953		Neni 13 – mungesa e mjeteve efektive në ligjin vendës për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse	15.9.2023	17.8.2023	3,600	-
2	1921/19 7.1.2019	Illirjan PROKO	Gumi Viktor Tiranë		15.9.2023	29.8.2023	3,600	250
3	44307/21 1.12.2021	Durim GRABOVA 1951			15.9.2023	5.5.2023	1,200	-

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuarve.

² Plus çdo taksë që mund t'u tarifohet kërkuarve.